



Në këtë numër të parë:



FRPD përgatit strategjinë zgjedhore



PS mbështet pjesmarrësit



Ish pjesmarrësit si konsulentë



Të afrojmë politikanët dhe qytetarët

Interneti mjet komunikimi për zgjedhësit e zonës Nr.41

nga Delina Korbi



Kohët moderne kanë sjellë internetin si mjet komunikimi më të shpejtë dhe më të përhapur, jo vetëm për të rinjtë, por për të gjitha moshat, në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Zona zgjedhore Nr.41, në qytetin e Tiranës, për shkak të vendodhjes (qendra e kryeqytetit) dhe gjëndjes sociale të banorëve, ka një numër të madh të përdoruesve të internetit. Këtë gjë e provon dhe fakti që një numër i konsiderueshëm personash kanë në përdorim, në familjet e tyre, kompjuter personal dhe shërbim interneti. Duke respektuar këtë specifikë të zonës zgjedhore Nr.41, me kontributin e pjesmarrësve Eteva Bisha dhe Delina Korbi dhe me financimin e fondacionit Sorros deputeti Musa Ulqini i mundësoi zyrës së tij elektorale përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit (shërbim interneti dhe e-mail), për të komunikuar me zgjedhësit e zonës. Në këtë mënyrë është e mundur që çdo ditë zgjedhësit të njihen me veprimtarinë e deputetit, duke klikuar në faqen www.musaulqini.com.al. Në këtë mënyrë deputeti mund të njihet përmes informacionit të dërguar me e-mail për problemet e zgjedhësve të tij.

Eveniment special i përzgjedhur nga tre pjesëmarrëse

nga Arta Sakja

Nën nismën e Lidhjes Demokratike të Gruas së Shqipërisë, dega Tiranë, NDI dhe Fondacioni Dora D'Istria, të premtën në 9 maj organizuan në ambientet e bar ValeVerde një eveniment special për mbledhjen e fondeve, i titulluar "Kjo është festa ...". Aktiviteti i konceptuar si një mbrëmje poetike dhe ndërthurur me fondmbledhje iu kushtua nënës, në ditën e cila që prej vitit 1906 festohet në të gjithë botën ndërsa në Shqipëri, ndonëse e ligjësuar si festë e nënës në vitin 1996, ka një traditë të vakët. Organizatorët e këtij evenimenti ishin tre pjesëmarrëset në programin e NDI për menaxhimin politik Arta Sakja, Antoneta Malja dhe Mimoza Hasekiu së bashku me zonjat Liljana Bejleri, kryetare e LDGSH për Tiranën dhe zonja Rajna Kovaci, drejtoreshë e Fondacionit Dora D'Istria. Ato e kishin konceptuar aktivitetin si një mundësi për të shkrirë së bashku dëshirën dhe mundësinë për të mbledhur së bashku artistë dhe udhëheqës politikë, gra dhe burra të profilizuar e të spikatur aty ku kontribuojnë, themelues dhe simpatizantë të PD. Aktiviteti u hap nga zonja Liri Berisha. Në të spikaste edhe pjesëmarrja e burrave ndër të cilët mund të përmendim sekretarin e përgjithshëm të PD Ridvan Bode dhe deputetë të tjerë të shquar të PD. Ky eveniment ishte kombinuar me një përpjekjen për mbledhje fondesh në dobi të LDGSH.



Pjesëmarrja e Grave në Politikë



Xhulieta Jaho organizoi në datën 30 Maj në Tiranë një training se si gratë mund të përparojnë në politikë. Duke trainuar së bashku me një kolege nga PS, ato mbuluan tema që përfshinin aftësitë prezantuese dhe të debatit në publik, zhvillimin e mesazhit dhe inkurajimin e grave për të kandiduar në zgjedhje. Aktivitetin e ndoqën 45 pjesëmarrës që përfaqësonin zyrtarët rajonalë të shtatë partive politike.

Përgatitja e Publikimeve Partiake



Roland Bejko organizoi një sesion trainimi se si të përgatiteshin dhe prodhoheshin publikime moderne partiake. Pjesëmarrësit e aktivitetit ishin 15 kryetarët e degëve të forumit rinor të PD në Gjirokastrë si dhe studentë dhe aktivistë të partisë.



Pjesmarrësi Këshilltar në Qeveri

Që prej tre muajsh Nikolin Kurti shërben si Këshilltar i Qeverisë në Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit në Departamentin e Emergjencave Civile. (tërmetet, bora, rënia e zjarreve, epidemitë, minat, ndotja e ambientit etj.)

Sfida e ngritjes së strukturave rinore

nga Alma Lahe



Për çdo forcë politike një objektiv i rëndësishëm është afrimi i rinisë dhe ngritja e strukturave rinore. Domosdoshmërinë e ngritjes së Forumit Rinor kishte vite që e ndjente edhe PBDNJ (pas vakumit të krijuar nga shkrirja e të parit). Ndaj menduam që punën për riorganizimin e rinisë ta realizonim në një formë të ndryshme nga tradicionalja. Dhe, për fat të mirë, "eksperimenti" doli me sukses. Çdo të mërkurë, një grup të rinjsh me status të ndryshëm (nxënës, studentë, intelektualë, etj.) mbledheshin në selinë e Partisë. Ata u ndanë në grupe të vogla pune, që në çdo takim informonin për punën e bërë. Grupet e punës hartuan një draft të Dispozitave Themelore të Forumit, Objektivat Kryesore, Plan-aktivitetesh (i cili u zbatua në vazhdimësi), ideuan dhe realizuan një fletëpalosje—ftesë, etj. Partia e mori me shumë seriozitet ngritjen e Forumit Rinor. Është domethënëse fakti që ishte vetë kryetari Vangjel Dule që, gjatë gjithë kohës, ishte jo thjesht drejtues i takimeve të përjavshme rinore, por edhe një pjesëtar i përhershëm i grupeve të punës. Konferenca e Forumit Rinor për të Drejtat e Njeriut, Dega Tiranë, ishte finalizimi i një pune disa mujore të këtij grupi të rinjsh. Dhe kushto që e ka ndjekur, qoftë edhe nëpërmjet medias, e ka kuptuar se ishte një sukses i vërtetë. (Në foto Alma Lahe)

PS mbështet pjesmarrësit

nga Taulant Balla



Në kuadër të programit të Menaxhimit Politik, që NDI zhvillon në Shqipëri, dhe me inisiativën e Sekretarit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Partisë Socialiste, z. Ilir Zela, më datë 6 Maj 2003, në selinë qendrore të PSSH u zhvillua një takim mes drejtuesve të lartë socialistë: z. Gramoz Ruçi - Sekretar i Përgjithshëm, z. Ilir Zela - Sekretar për Marrëdhëniet

Ndërkombëtare, përfaqësuesve NDI në Shqipëri: znj. Jennifer Butz - Drejtore e Institutit, z. Dan Redford - Drejtor i Programit për Partitë Politike, dhe përfaqësuesve të PS në Programin e ri të NDI. Sekretari i Përgjithshëm i PSSH vlerësoi si shumë të rëndësishëm rolin që NDI luan në Shqipëri nëpërmjet asistencës me karakter trajnues ofruar partive politike. Gjithashtu, z. Ruçi vlerësoi se përfaqësuesit e PSSH, në programet e NDI kanë përfituar njohuritë e nevojshme dhe eksperiencën për të përballuar me sukses sfidat progresiste të zhvillimit dhe të promovimit të vlerave integruese. Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi politikanët e rinj të PSSH që trajnohen nga NDI, për rezultatet e shkëlqyera të arritura gjatë modulit të parë, rezultate këto të reflektuara si në kuadër të seminareve, ashtu edhe në programet personale të secilit prej pjesëmarrësve.

FRPD përgatit strategjinë zgjedhore

nga Rovena Muzhaqi

Andi Lila (ju lutem shihni foton) dhe Rovena Muzhaqi organizuan një training mbi strategjinë dhe organizimin e fushatës zgjedhore në Durres 31 Maj. Pjesmarrësit që ndoqën trainingun ishin 45 kryetarët rajonalë të forumit rinor të PD. Ky training është shoqëruar me rezultate që kanë sjellë momentalisht efekte pozitive. Së pari, Andi Lila u ftua në televizionin e qytetit "Teuta TV" për të folur për punën e tij dhe me këtë rast për të ngritur profilin e tij. Së dyti, Znj Topalli ka kërkuar që ai të jetë përgjegjës për organizimin e trainimeve të forumit rinor për të gjitha inisiativat e ardhshme. Së treti, në vazhdim të debatit që nisi gjatë trainingut tani duket e sigurt se forumi rinor në rang kombëtar ka ndërmend që të institucionalizojë proceset trainuese për të krijuar një Institut të partisë për një punë të tillë. Së katërti, Andi dhe Rovena në mënyrë të vazhdueshme theksuan nevojën e të dëgjuarit të votuesve në mënyrë aktive — një mesazh i cili u përsërit intensivisht gjatë evenimentit të përbashkët të programit të NDI për partitë politike dhe



Opinione për NDI



Alban Zusi:

Program - shkolla politike e NDI stimulon formimin vizionar dhe menaxhues të politikanit, duke e orientuar drejt standarteve përëndimore të binomit eficiency - etike.



Rovena Muzhaqi:

Ky program kompletion portretin tonë si aspirantë politike. Ai rrit vetbesimin dhe na bën të aftë të jemi përfaqësues të denjë të grupit politik të cilit i përkasim.



Desdemona Gaba:

Nuk është e lehtë të krijosh një brez të ri politikanësh, me një psikologji moderne dhe përëndimore. Këtë gjë NDI po e realizon në Shqipëri, me sukses të plotë.

Suksesi i pjesmarrësve në zgjedhjet e FRESH-it

nga England Cacaj

Në këtë Kongres pati një pjesmarrje të rinjsh nga të gjitha degët vendore të FRESH-it të cilat përfaqësoheshin me 410 delegatë. Ndër diskutantët më të spikatur në seancat e Kongresit, ishin edhe zhupistët Elvis Mataj (djathtas), England Cacaj (majtas poshtë), Taulant Balla, Saimir Dashi dhe Delina Korbi, të cilët treguan jo vetëm përgatitje politike, por përcollën edhe një frymë të re. Më pas u procedua në



zgjedhjen e Kryetarit të FRESH dhe të Komitetit të Përgjithshëm Drejtues. Me shumicë votash, Kryetar i Forumit Rinor Eurosocialist u zgjodh zoti Gjergji Koja. Ndërkohë që, tre nga pjesëmarrësit në Programin e Menaxhimit Politik, të zhvilluar nga NDI, përkatësisht England Cacaj, Elvis Mataj dhe Taulant Balla u zgjodhën anëtarë të Komitetit të Përgjithshëm Drejtues. Në mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues u zgjodhën edhe strukturat drejtuese. Zhupisti Elvis Mataj u zgjodh nënkryetar i FRESH dhe England Cacaj Sekretar i Marrëdhënies me Jashtë.



Rritja e Rolit të Partisë në Zhvillimin e një Shoqërie Demokratike

nga Mimoza Hysaj

Në ditët e para të Majit në qytetin e Durrësit, filloi zbatimi i Projektit: "Rritja e rolit të Partisë në zhvillimin e një shoqërie demokratike", bashkëpunim ky ndërmjet NDI dhe Degës vendore të PD. Ky projekt përbëhet nga 6 module: Organizimi i partisë, Roli i menaxherit të partisë, Organizimi i fushatës elektorale, Roli i gruas në politikë, Politikat e negociimit të kompromisit, Organizimi i evenimenteve dhe mbledhja e fondeve. Në kuadër të projekteve, trajnierët Mimoza Hysaj, Klodian Pajuni, Tonin Çefa, pjesëmarrës të programit "Zhup", zhvilluan modulën e parë "Organizimi i partisë", me pjesëmarrjen e strukturave drejtuese të degës, nëndegëve, deputetëve, këshilltarëve vendorë, organizatave partnere, etj. Seminarin e përshendetën kryetari i PD-së, Durrës, z.Edmir Kapidani, dhe Drejtori i Programit për Partitë Politike, pranë NDI në Shqipëri, z.Dan Redford. Objektivi ishte përmirësimi i aktivitetit të degës në prag fushate, ballafaquar me eksperiencat e vendeve perendimore. Temat kryesore ishin: Motivimi i antaresisë dhe vendim-marrja, Zhvillimi i mesazhit dhe mbledhja e fondeve, Trajnimi dhe zhvillimi. Në fund të aktivitetit, pjesëmarrësit vlerësuan domosdoshmërinë e zhvillimit të trajnimeve të përherëshme si dhe nevojën e krijimit të strukturave trajnuese të posaçme. U konsiderua i rëndësishëm zbatimi i sistemit një anëtar një votë, i aplikuar në zgjedhjet vendore, por që mund të praktikohet edhe në zgjedhjet brenda partisë, veçanërisht në përzgjedhjen e kandidatëve në të gjitha nivelet. (Në foto Mimoza Hysaj)



Politikanët e rinj dhe decentralizimi i pushteteve

nga Edvin Zoto

Decentralizimi i pushteteve mbledhi në një tryezë të rrumbullakët, në Durrës, krerët më të lartë të pushtetit vendor të këtij qyteti, përfaqësues të forcave politike dhe përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Vendor në një seminar të organizuar nga z.Reiz Mulita, (foto majtas) pjesëmarrës në programin ZHUP (Zhvillimi i Udhëheqësit Politik) të NDI, në bashkëpunim me Fondacionin Publik Gjerman "Friedrich Ebert". Z. Mulita theksoi se ky seminar, i organizuar edhe në qytete të tjera të Shqipërisë si Lezhë, Berat, Korçë e tani edhe në Durrës, mbart në vetvete jo vetëm decentralizimin e pushteteve, si një proces i domosdoshëm për ta çuar pushtetin sa më pranë komunitetit, por edhe bashkëpunimin e klasës politike në këtë proces, si një faktor kyç për realizimin e suksesshëm të tij. Prioritetet kryesore, theksoi znj.Paço, janë, padyshim, arsimit, shëndetësia, transporti,

mjedisi, që përbëjnë edhe një shqetësim real për komunitetin, i cili, nga ana e tij, duhet të jetë pjesë aktive e këtij procesi, pasi decentralizimi i pushteteve, në vetvete, s'është gjë tjetër veçse kalimi i pushtetit sa më pranë komunitetit. Në seminar diskutuan të gjithë pjesëmarrësit, përfaqësues të pushtetit vendor dhe partive politike, të cilët theksuan se, në këtë proces të gjatë të decentralizimit, është i domosdoshëm bashkëpunimi i partive politike dhe i institucioneve ekzekutive me ato vendore, sepse, pa këtë bashkëpunim, ky proces nuk do të ketë mundësi të realizohet e të japë frytet e tij në dobi të komunitetit.

Të reja nga partia Balli Kombëtar

nga Florian Xhuti

Nisma e marrë nga përfaqësues të Partisë Balli Kombëtar dhe Balli Kombëtar Demokrat për një bashkim të mundshëm, ku Z. Florian Xhuti pjesëmarrës i programit ZHUP ka një kontribut të rëndësishëm, është kthyer tashmë në Vendim nga Këshillat Kombëtarë respektive të dy partive dhe tani ndodhet në fazën më të vullshme të saj. Në kohët ku jemi, kur të dyja partitë i përkasin të njëjtës alencë politike, kur programet e tyre nuk kanë asnjë lloj diference, kur programet janë të njëjta, atëherë ballistët vendosën të lenë mënjanë luksin e tepërt — të qënë të ndarë. Problemin që në tërësi politika shqiptare vuan, pra çështjen e personaliteteve, të dyja partitë po e zgjidhin duke zhvilluar konferencat e përbashkëta në degët e partive në rrethe, që do të çojnë në Kongresin e Bashkimit të Ballit Kombëtar Shqiptar. Me këtë akt, ballistët i sjellin në vëmendje opozitarëve në Shqipëri edhe atë se, për sa kohë partitë e tyre do t'i ngjajnë një orkestre ku instrumentistët e luajnë melodinë në kohë të ndryshme, - vetëm një gjë kanë të sigurtë, - qënien në opozitë. Ndërkohë Desdemona Gaba dhe Florian Xhuti organizuan në Shkodër 31 Maj një training me partinë e tyre në temën "Një anëtar një Votë", organizimin e degës së partisë dhe si të bëhemi menaxherë të mirë. Pesëmbëdhjetë pjesëmarrës morën pjesë në training që përfshinin kryesitë e rretheve të Shkodrës dhe Pukës si dhe përfaqësues nga forumet lokale të rinisë dhe gruas.(foto djathtas)



Organizimi i degës dhe mbledhja e fondeve

Flamur Noka organizoi një training në Fier, në javën e dytë të Majit, i cili mbulonte temën e organizimit të degës së partisë. Të 250 pjesëmarrësit që ndoqën aktivitetin ishin kryetarë të degëve dhe



nëndegëve të forumit rinor të PD në Fier si dhe anëtarë të kryesive të strukturave respektive.Projekti i dytë i Flamurit ishte një aktivitet i mirëfilltë i mbledhjes së fondeve duke përdorur njohuritë e përfituara në seminarin përkatës të programit. Të 200 pjesëmarrësit ishin kryetarë të degëve dhe nëndegëve të PD në Elbasan dhe anëtarë të kryesive të këtyre strukturave. Aktiviteti u filmua dhe gjeti pasqyrim në median lokale.

Angazhimi i rinisë në politikë

Pashk Alia organizoi një training se si të tërhiqte rininë tek partia e tij dhe si të rriste bashkëpunimin ndërmjet forumit rinor dhe



Partisë Socialiste. Në aktivitet morën pjesë 40 pjesëmarrës, shumica e të cilëve ishin anëtarë të forumit rinor të zonës. Folësit përfshinin , Monika Kryemadhi kryetare e FRESH për Tiranën.



Mirëadministrimi i taksave vendore, shërbim për qytetarët

nga Artan Çela

Mbledhja dhe mirëadministrimi i taksave vendore në dobi të komunitetit përbëjnë bazën e projektit të menazhuar nga Agron Sula, përfaqësues i programit "Zhup". Në këtë projekt që është zbatuar në rrethet Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë, janë përfshirë në trajnime mbi 150 punonjës që shërbejnë në administratat e komunave dhe bashki.

Mbulimi financiar për zbatimin e këtij projekti është bërë i mundur nga World Learning dhe USAID. Grupi i trainuesve, të specializuar jashtë vendit, gjatë sezoneve të trajnimit kanë evidentuar problemet aktuale që lidhen me financat dhe decentralizimin e pushtetit vendor. Ata kanë dhënë për të trajnuarit vendorë informacionin e nevojshëm për krijimin e një sistemi frutdhënës në mbledhjen dhe mirëadministrimin e taksave vendore. Në të njëjtën kohë, grupi i trajnuesve ka bërë prezent mënyrat që duhet të ndiqen për identifikimin dhe klasifikimin e subjekteve taksapagues, si të komunikojmë me ta dhe kush mund të përfshihet në taksat e reja. (Në foto Agron Sula)

Nxitja e Pjesëmarrjes së Grave në Politike

nga Liliana Mera



Liliana Mera organizoi gjatë dy javëve të para të muajit maj, dy trainime për gratë e angazhuara në politikë. Aktiviteti i parë u zhvillua në qytetin e Tiranës ku morën pjesë 35 pjesëmarrëse që përfshinin këshilltarë lokalë, zyrtarë dhe aktivistë lokalë të partisë. Liliana përsëriti këtë training në Përmet. Të 40 pjesëmarrësit që ndoqën aktivitetin e Lilianës ishin këshilltare lokale, zyrtarë dhe aktivistë lokalë të partisë. Trainerët përfshinin edhe një pjesëmarrëse të fazave të mëparshme të programit të NDI, e cila është aktualisht kryetare e këshilltarëve të PS në bashkinë e Tiranës.

Rritja e anëtarësisë në PSD

nga Anila Osmani

Seminari i parë i modulit prej gjashtë seminaresh që unë, ashtu si çdo pjesëmarrës i programit më të ri të NDI po organizoj, u zhvillua në ambientet e qendrës "Univers", me pjesëmarrjen e simpatizantëve dhe anëtarëve të Forumit të Rinisë Socialdemokrate. Qëllimi kryesor ishte inkurajimi dhe kthimi i mbështetësve të Partisë, në antarë aktivë dhe pjesmarrja dhe angazhimi i tyre në aktivitet politik. Temat ngjallën interes tek pjesmarrësit. I gjithë diskutimi u organizua në formën e një workshop, që nuk kishte qëllim që të dëgjohej vetëm zëri i moderatorit, por edhe i vetë pjesmarrësve. Të kuptuarit e arsyes përse qytetarët antarësohen në një parti dhe përse qëndrojnë dhe punojnë në të është jo vetëm e vështirë për të gjetur përgjigje, por është edhe çelësi i nxitjes e përfshirjes së antarëve të rinj. Ne debat u theksua se ndër metodat më të mira për shndërrimin e një simpatizanti apo mbështetësi në antar partie është kontakti personal, madje, disa e lidhen edhe me organizimin e trainimeve të tilla, ku secili të shprehë dhe rrahë mendime për çështje të antarësisë dhe komunikimit politik



PS: Trainimi i strukturave vendore

nga Artan Çela

Në datat 8 dhe 10 maj, Artan Çela, pjesëmarrës nga PS në programin e menaxhimit politik të NDI, organizoi tre trajnime në rrethin e Permetit. Tema e të tre trainimeve ishte "Krijimi i një skuadre për fushatë". Në trajnimin në qytetin e Permetit, pjesëmarrësit ishin aktivistë, funksionarë të degës dhe këshilltarë vendorë të PS. Artan Çela u vu në rol in trainerit, për të komunikuar me kolegët e tij ato njohuri që kishte fituar gjatë ndjekjes së programit dhe që, të kombinuara me përvojën e tij të deritanishme, përbënin elementë të rëndësishëm që mund të ndihmonin degën e PS në Përmet në ato aspekte ku ajo duhej të përmirësohej. Dy trainimet e tjera u zhvilluan në komunat Sukë dhe Çarshovë, me këshilltarët vendorë të PS dhe tema ishte po ajo e organizimit të skuadrës për fushatën zgjedhore. Në përfundim të trainimeve, pjesëmarrësit e vlerësuan cilësinë e trainimit si të shkëlqyer dhe mendojnë se ky training ishte i dobishëm për punën e tyre të ardhshme.



Opinione për NDI



Elvis Mataj:

Ky do të listohet si programi, i cili formatoi politikanët që i dhanë të ardhme Shqipërisë.



Arben Qirjako:

Është një projekt interesant dhe dobiprurës për gjithkënd që di ta vlerësojë.



Merita Myftari:

Programi po fuqizon kapacitetet dhe pasuron aftësitë e politikanëve të rinj për të menaxhuar partitë e tyre sipas modeleve të përparuara perëndimore

Programi Menaxhimi politik – sukcesi i radhës së NDI

nga Enri Prodani

Kursi Trainues i Menaxhimit të Partive Politike filloi në shkurt 2003, pas një procesi përzgjedhjeje të pesëdhjetë aplikantëve më të mirë, nga një sërë partish politike shqiptare. Pjesëmarrësve në këtë program u janë ofruar njohuri dhe eksperiencë nga vende perëndimore demokratike, me një traditë tashmë të konsoliduar të organizimit politik. Ndërkohë që kursi është ndërtuar në katër module, që do të trajtohen në harkun kohor të një viti, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të eksplorojnë tema të përfshira në dy modulet e para. Moduli i Organizimit të Partive Politike përfshiu temat: Roli i partive politike, Sistemet elektorale, Organizimi i partisë, Zhvillimi i mesazhit,



Roli i menaxherit të partisë, Anëtarësia, Mbledhja e fondeve, Organizimi i evenimenteve, Trainimi dhe zhvillimi. Të pyetur në fund të modulit të parë nëse programi ishte i dobishëm për ta, 95 përqind e atyre që kthyen përgjigje thanë "po", ndërkohë që pothuaj 100 përqind e pjesëmarrësve e konsideronin punën individuale për transmetimin e njohurive të fituara te kolegët në parti të tyre si "të rëndësishme" dhe "shumë të rëndësishme". Në komentet e tyre, një nga pjesëmarrësit e cilësoi programin si "një nga programet më të mirë për njerëzit e angazhuar në politike", ndërkohë që një tjetër e cilësoi informacionin e ofruar si "veçanërisht të dobishëm në fushatë zgjedhore". Tashmë në kurs po trajtohen tema të modulit të dytë, i quajtur Menaxhimi i Fushatës Zgjedhore, të cilat do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit gjatë punës në parti të tyre në përgatitjet për zgjedhjet vendore në tetor të këtij viti. Këto tema përfshijnë: Kandidati për post publik, Të Fitosh përzgjedhjen, Organizimi i fushatës, Nxitja e pjesëmarrjes rinore, Posterat dhe fletëpalosjet, Posta direkte dhe interneti, Fushata në zona rurale etj. (Në foto Enri Prodani)

Shkolla Trainuese mbi Organizimin Politik

nga Alma Lahe

Ditën e shtunë, më 5 prill 2003, në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, zhupistët morën pjesë në seminarin njëditor mbi Organizimin Politik. Gjatë gjithë seminarit-shkollë pjesëmarrja ishte e kënaqshme dhe interesimi i madh. Shkolla ishte e dobishme jo vetëm për temat interesante, të tilla si: Zhvillimi i mesazhit, Trajnimi dhe zhvillimi, Mbledhja e fondeve etj., por edhe për mënyrën e trajtimit nga ana e

lektorëve: Damian Murphy- trainues i NDI në Serbi, Chris Henshaw - menaxher rajonal i Partisë Laboriste në Mbretërinë e Bashkuar dhe Barbara Ko (SHBA) – trajnuese e NDI. Dita u hap me përshëndetjet e drejtorit të USAID-it në Shqipëri, Herri Birnholz. Tepër interesante ishte edhe tema: Mbledhja e fondeve dhe Organizimi i ngjarjeve, që zgjoi interesin e të gjithëve, edhe për faktin se në parti të politike shqiptare, ende nuk ka hyrë koncepti i mbledhjes së fondeve. Madje, jo rrallë, në pyetjet dhe në komentet e tyre, zhupistët u shprehën skeptikë nëse forma të tilla mund të realizoheshin, tani për tani, në Shqipëri(?!). Nga lektorët u vu në dukje se bashkëpunimi i ngushtë dhe hap pas hapi i çdo politikani me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interësit lehtëson punën e tij dhe i siguron fitoren. Sesioni i Pyetjeve ishte shumë i gjallë, gjë që tregoi se seminari ishte me të vërtetë i ndërësant dhe i frutshëm për të gjithë.



Ish pjesëmarrësit si konsulentë

nga Guri Daco

Ne arritëm të merrim aprovimin e 13 ish-ZHUPistave për të ndihmuar pjesëmarrësit aktualë në trainimet dhe aktivitetet e projekteve të tyre, duke u siguruar atyre mbështetje këshillimore aty ku do të jetë e nevojshme. Në 30 maj ne i ftuam në një aktivitet shoqëror ku shpjeguam në detaje synimin e kësaj skeme dhe ata morën certifikata për të konfirmuar rolet e tyre dhe theksuar kontributin e tyre brenda partive. Ata vlerësuan faktin që NDI ishte aty për t'i ndihmuar në punën e tyre politike. Për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve, çdo pjesëmarrës do të ftohet çdo muaj në një takim për të diskutuar çështje në lidhje me personat që ata po asistojnë. Gjithshtu, në aktivitetin shoqëror pati një debat të shkëlqyer mbi sistemin "një anëtar një votë" dhe duket se do të mblidhemi sërish për një aktivitet të këtij lloji.

Një fillim i mirë për pjesëmarrësit

nga Saimir Dashi

Ishte tepër emocionues për mua lajmi që NDI do të fillonte një program të ri dhe, kur ndër të përzgjedhurit isha edhe unë isha me të vërtetë i njohur. Në këtë "grup" të përzgjedhur ndjen se mund të formosh kapacitetin tënd për të ndryshuar politikën e sotme shqiptare. Era e ndryshimit po vjen, të nderuar kolegë. Sepse jemi ne ata që duhet ta çojmë përpara fladin e kësaj ere, pavarësisht nga vështirësitë e shumta që do të hasim rrugës. Qëndrimi ynë të jetë sa më i dukshëm dhe produktiv dhe të dihet se cilët jemi dhe kë përfaqësojmë, duhet bërë një punë edhe më e madhe për të krijuar lidhjet midis nesh dhe liderave të Partive tona politike. Ne nuk duhet të heshtim, jehona e mendimeve dhe ideve tona duhet të përcillet tek çdo shqiptar. Prandaj, çdo ditë, çdo moment, çdo sekondë në duhet të ndiejmë atë forcë që na bën të vetëdijshëm për fatin që kemi për të lënë diçka të shënuar në histori, si brezi i parë i politikanëve që do të ndryshojnë Shqipërinë dhe do e fusin në Evropë. Ky fillim ka ardhur dhe ne nuk duhet ta humbim këtë shans.



Të afrojmë politikanët dhe qytetarët -NDI organizon një dialog për të ndihmuar në ngushtimin e hendekut

nga Jennifer L. Butz dhe Dan Redford

Në 23 dhe 24 Maj, Instituti Kombëtar Demokratik organizoi tre dialogje publike në Tiranë, Kavajë dhe Durrës që i drejtoheshin hendekut në rritje ndërmjet qytetarëve dhe politikanëve në Shqipëri. Kjo seri tregoi se këto dy grupe të ndryshme ndajnë të njëjtët shqetësime dhe mund të ngrenë diskutime produktive të orientuara drejt zgjidhjes. Veprimtari të njëjta janë planifikuar për në 24 dhe 27 Qershor në rrethet e Shqipërisë së Mesme. Folësit përbëheshin nga 25 anëtarë të Programit të Zhvillimit të Partive Politike të NDI dhe 48 anëtarë stafi dhe pjesëmarrës nga Forumi Civil, një program i NDI për edukimin e qytetarëve dhe advokimin e tyre. Gratë dhe burrat u paraqitën me numër të barabartë. Pjesëmarrja e gjerë – 36 politikanë nga nëntë parti politike dhe 75 individë nga 34 komunitete nga Shqipëria e Mesme – pasqyron një dëshirë të madhe për një dialog të hapur dhe konstruktiv ndërmjet përfaqësuesve politikë dhe zgjedhësve të tyre.

Pyetja kyçe e diskutimit – si të ngushtojmë hendekun ndërmjet publikut dhe përfaqësuesve të tyre politik – u shqyrtua me anë të katër pyetjeve-secilës prej skuadrave prej pesë qytetarësh dhe pesë politikanësh iu dhanë nga 10 minuta për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Më poshtë ndodhen disa nga idetë dhe rekomandimet e tyre:



Çfarë kontribuon në krijimin e hendekut?

Sipas të dy palëve, kultura e varfër demokratike e Shqipërisë, premtimet e papërbushura të fushatave, indiferenca publike dhe mospërputhja ndërmjet hartimit dhe zbatimit të ligjeve, të gjitha këto zgjerojnë hendekun.



Si mundën këto grupe të zhvillojnë dhe zbatojnë platforma të bazuara në politika?

Qytetarët dhe politikanët identifikuan nevojën për të krijuar më shumë mundësi për dialog që do të nxishte platforma të përshtatshme, realiste dhe në të njëjtën kohë dhe vizionare. Mbledhja dhe shpërndarja e qëndrueshme dhe sistematike e informacionit është thelbi i këtij procesi, duke përfshirë dhe përpjekjet derë më derë, letrat, dhe grupet këshillimore që përfshijnë dhe anëtarë të ndryshëm të komunitetit.

Çfarë hapash mund të merren për të

përmirësuar përgjegjshmërinë dhe transparencën?

Pjesëmarrësit identifikuan komunikimin e ekuilibruar, të qëndrueshëm dhe të drejtpërdrejtë midis qytetarëve, politikanëve dhe qeveritarëve si vendimtar në krijimin e besimit dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Qytetarët drejtuan gishtin te procesi i buxhetit bashkiak si një mundësi për tu angazhuar dhe për t’i bërë zyrtarët vendorë llogari dhënës. Politikanët inkurajuan miratimin e ligjit për deklarimin e pasurive të deputetëve, duke organizuar anketime të rregullta për matjen e opinionit të qytetarëve dhe për publikun që të marrë një rol më aktiv për t’i bërë zyrtarët dhe partitë politike më të përgjegjshme.

Si mund, partitë politike dhe qeveria, të jenë më të hapur ndaj kontributit qytetar; ç’mund të bëjnë qytetarët që të japin ide?

Të dyja grupet ofruan masa pragmatike, duke përfshirë ndarjen në kohë e duhur të vendimeve të marra nga zyrtarët; përdorim më i mirë i medias; mbajtja dhe respektimi i orarit në zyrat pranë zonave zgjedhore; marrja pjesë në mbledhjet e këshillit; dhe angazhimi në një dialog të ndershëm si ky në të cilin ata morën pjesë.

Opinione për NDI



Edvin Zoto:

Programi ZHUP është shkolla e madhe e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për politikanët e rinj. Mendoj se kjo i shërben më së miri të ardhmes së Shqipërisë.



Andi Lila:

NDI në Shqipëri, me trainimet që kryen, aspiron krijimin e një klime të re politike sipas modelit të demokracisë perëndimore.



Voltana Ademi:

Programi i menaxhimit Politik të NDI është një eksperiencë e jashtëzakonshme për mua.

Shkolla e menaxhimit të fushatës elektorale

nga Alma Lahe




Organizimi i fushatës elektorale, njohja dhe zbatimi i të gjitha hallkave të saj janë kyç për suksesin e çdo force politike në zgjedhje. Pikërisht për këtë arsye, NDI zhvilloi shkollën e dytë, më 7 qershor 2003, me temë “Menaxhimi i fushatës elektorale”. Ashtu si në shkollën e parë, lektorët, që vinin nga vende dhe eksperiencia të ndryshme, sollën mjaft njohuri të vlefshme dhe interesante për pjesëmarrësit. Trajnerët Alex Finnen, Chris Henshaw dhe David Dougherty trajtuan tema të tilla, si prodhimi i fletëpalosjeve për fushatë, kontakti derë më derë dhe me telefon me votuesit, hartimi i strategjisë së fushatës, sondazhet për mbledhjen e opinionëve, etj. Shumë interesante ishte veçanërisht tema “Menaxhimi i operacionit të ditës së votimit”, gjatë të cilit u theksua se kjo ditë është vendimtarja në rezultatin e zgjedhjeve. Pjesmarrja në këtë shkollë ishte e mirë dhe zhupistët ishin mjaft të interesuar të thellonin njohuritë e tyre veçanërisht në organizimin e fushatës elektorale pasi të gjitha partitë politike shqiptare tani ndodhen përpara një fushate elektorale dhe një procesi zgjedhor tepër të rëndësishëm.

Mbi progresin politik të “veteranëve” të programit ZHUP

nga Guri Daco



Njëra prej arsyeve të suksesit të programit të ri të NDI mbi Menaxhimin Politik ka qenë edhe kontributi që kanë dhënë pjesmarrësit në fazat e para të programit ZHUP, nëpërmjet demonstrimit të ndihmesës që programi i NDI ka dhënë në zhvillimin e tyre politik. Në këtë numër po përshkruajmë arritjet e vetëm 4 pjesmarrësve të programit ZHUP, të cilat do të pasurohen me të tjera në numrat vijues:



Eva Allushi, PS - Zhup I

Rizgjidhet Sekretare e Marëdhënieve me Publikun në PS, dega Tiranë — Maj 2001; Kryetare e grupit socialist të këshilltarëve në Këshillin Bashkiak, Tiranë - Nëntor 2001; Anëtare e Kryesisë së Këshillit të Qarkut Tiranë - Dhjetor 2001; Anëtare e Kryesisë së Forumit Socialist të Gruas — 2000; Sekretare e Këshillit Socialist të Qarkut Tiranë — 2002.



Arben Hoxha, PBK - Zhup II

Rizgjidhet kryetar i degës së PBK, Korçë — 2001; Kandidat për kryetar në Bashkinë Korçë — 2000; Kandidat për deputet i PBK për zgjedhje parlamentare — 2001; Me ndihmën e NDI, hartoi dhe zhvilloi tryeza politike për pranimin e një kodi sjelljeje në fushatë zgjedhore - për zgjedhjet vendore të 2000;



Sandër Marku, PD - Zhup Rajonal

Zgjidhet kryetar i degës vendore të Forumit Rinor të PD, Lezhë - Prill 2002; Zgjidhet anëtar i Kryesisë së degës së PD, Lezhë - Maj 2002; Zgjidhet anëtar i Këshillit Kombëtar të FRPD — Maj 2002.



Ervin Shpori, PSD - ZHUP Rajonal

Kryetar i rinise Social Demokrate 2001; Riorganizoi rininë, veçanërisht degën Tiranë ku mbledhi 400 anëtarë dhe organizoi 11 nëndegë. Pjesmarrje rinore në fushatë. Sukses i tij konsiderohet vendimi i partisë që kandidatët që vijnë prej rinisë të jenë të dytët ose të tretët në listat e kandidatëve për këshilltarë bashkiakë në zgjedhjet lokale 2003.

Profil:

Pjesmarrësit nga PR dhe PSD

nga Artan Çela

Politikanët e rinj të trainuar nga NDI ndihen mjaft të motivuar dhe të integruar në jetën dhe strukturat politike të Partisë Republikane. Ata tregojnë se ndikimet e tyre politike në këto struktura janë në nivele të larta, si

zëdhënës, anëtarë të komitetit drejtues, Anëtarë të asamblesë kombëtare dhe roli i tyre është mjaftë dominues dhe shprehshëm



për të ardhmen e partisë pasi dhe vizioni që ata kanë për demokracinë dhe politikën është i gjerë, falë kjo dhe punës së mirë të NDI

Po kaq komodë ndihen edhe politikanët e rinj në Partinë Social-Demokrate. Marrëdhëniet e tyre me strukturat drejtuese të Partisë, ata i cilësojnë si shenjë partneriteti dhe jo vartësie. Ata shprehen se të rinj socialdemokratë kanë ndikime mbi politikën e PSD-së dhe, në disa raste, me inisiativën e tyre, janë organizuar një sërë



evenimentesh për prezantimin e politikanëve të Partisë te të rinjtë.

Kjo gjë, shprehen ata,

ka influencuar në shtimin e radhëve të Partisë me elementë të rinj. Gjithësesi, në disa raste, mungesa e demokracisë së brendshme ka bërë që disa të rinj të mos jenë të pozicionuar në strukturat që u takojnë sipas kontributeve të dhëna, për partitë e tyre. (Në foto: sipër Edvin Zoto PR, poshtë Nevila Bejleri PSD)

Opinione mbi sistemin: *Një Anëtar Një Votë*



Roland Bejko, PD

Në shumicën e vendeve Perëndimore partitë politike në praktikë aplikojnë sistemin një anëtar një votë. Në këto vende, ky sistem ka dhënë rezultate pozitive; anëtarët e partisë e ndjejnë veten pjesëmarrës dhe të konsideruar nga partia. Ata ndihen të rëndësishëm sepse vota e tyre është e rëndësishme. Vota e tyre përcakton kush do të jetë kryetari i partisë në qendër dhe në vendoritete, kush do të jetë kandidati për kryetar bashkie, kush do të jetë deputet etj. Përfitimet janë të ndërsjella. Anëtarët do të shtojnë interesin ndaj partisë dhe aktiviteteve të saj, do të rritet pjesëmarrja edhe në votimet elektorale, do të decentralizohet partia, do të ketë më shumë financime etj. Ndërsa kandidatët që do të dalin nga vota e të gjithë anëtarëve do të kenë besimin e shumicës, do të jenë më të sigurt dhe më të vendosur në punën e tyre, me një sens të lartë për t'a zotëruar dhe për t'a administruar pushtetin. Ata do të jenë të prirur të respektojnë llogaridhënien ndaj votuesve dhe, çështje me kryesorja, të gjithë do të kenë mundësinë të çlirohen nga komplekset e unitarizmit dhe autoritarizmit të liderit absolut dhe të gjithëpushtetshëm në qendër dhe në bazë.

Në Shqipëri tashmë dihet që forma klasike e organizimit dhe funksionimit të partive shqiptare nuk është me e mira dhe më demokratikja, por e justifikojnë këtë konservatorizëm me faktin se votuesit shqiptarë nuk mund të aderojnë dhe të militojnë në një strukturë politike që është larg dhe jashtë përfytyrimit klasik të egzistencës së partisë të tipit "Parti e Punës". Sipas tyre, çdo lloj forme tjetër organizimi do të ishte e pakuptimtë dhe e pa absorbueshme nga anëtarët e partisë.

Prandaj edhe sistemi një anëtar një votë është shumë i vështirë për t'u zbatuar brenda partive shqiptare. Ka patur një tendencë të PD-së për ta aplikuar këtë sistem në Zgjedhjet Vendore të 2000, për zgjedhjen e kandidatëve për kryetarë bashkish dhe komunash, por, për fat të keq, kjo provë dështoi. Megjithatë demokracia kërkon reforma dhe reformat kanë kosto.



Taulant Balla, PS

Një anëtar — një votë, sfida e së ardhmes për partitë politike shqiptare. Kultura demokratike tashmë më shumë se kurrë është çelësi për të arritur jo vetëm një shoqëri globale më të barabartë por gjithashtu edhe një botë më paqësore dhe më të sigurtë. Kur njerëzve u jepet mundësia të shprehin lirshëm dhe të marrin pjesë direkt në vendim marrje, sigurisht që përgjigjen me entuziazëm dhe përkushtim. Kjo siguron legjitimitetin e cdo elite drejtuese dhe është garanci për një stabilitet dhe progres të vazhdueshëm.

Partitë politike, është si çdo formë e organizimit politik, zgjedhin nëpërmjet normave të tyre statutove formën e shprehjes së vullnetit të anëtarëve të partisë. Një anëtar — një votë nënkupton shprehjen e vullnetit të anëtarëve nëpërmjet pjesëmarrjes direkte në zgjedhjen e strukturave drejtuese, në formulimin e programeve politike dhe në debatin e brendshëm të partisë.

Aktualisht në Shqipëri, në përgjithësi partitë politike kanë të sanksionuar me statut se pjesëmarrja direkte zëvendësohet nga delegimi i autoritetit të votës nëpërmjet përfaqësimit. Personalisht mendoj se kjo formë organizimi, për vetë infrastrukturën ekzistente të komunikimit në Shqipëri, kërkon kohë të zëvendësohet, por ajo mbetet gjithmonë e përkohshme.

Aplikimi i sistemit një anëtar një votë nuk do të vonojë shumë, por kjo do të varet shumë edhe nga shkalla dhe koha e krijimit të maturitetit politik të partive shqiptare dhe nga aftësia e tyre për zhvillim dhe progres bazuar jo mbi kritere sasiorë për mbi kritere cilësorë.

Opinione për NDI



Florian Xhuti:

ZHUP dhe trajnimet vijuese i konsideroj si punën më me themel që institucionet ndërkombetare kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë me shqiptarët për sa i takon politikës.



Delina Korbi:

Unë marr pjesë në këtë program sepse dëshiroj të bëhem një menaxhere në partinë time, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore.



Atlje Cani:

Mirënjohje NDI për punën që bën në përgatitjen e një grupi politikanësh të moderuar për një administrim ndryshe të politikës shqiptare.

Mundësi për të gjithë:

Si mund të krijojnë gratë një Shqipëri më të mirë?



Të mos kuptosh apo të mos duash

nga Antoneta Malja

Është paksa e vështirë të flasësh për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare. Kjo për vetë raportet e disfavorshme të krijuara në kurriz të gruas. Roli i femrës në shoqërinë shqiptare është i papërfllshëm, megjithëse ajo përbën rreth 52% të saj, për më tepër që 65% janë nën moshën 40-vjeçare. Pra, rreth një milion gra dhe vajza, që janë padyshim pjesa më aktive, izolohehen dhe kapaciteti i tyre intelektual nuk vihet në shërbim të komunitetit dhe kjo për shumë arsye. Sot, në Parlamentin prej 140 deputetësh ka vetëm me 8 deputete, shifer që nuk është pare as edhe në diktature. Perjashto raste të rralla, ajo përfaqësohet maksimalisht deri në nivelin e sekretareve, me kusht që ato të jnë të hijshme e të pamshme. Diku-diku për të rregulluar imazhin e qeverisjes, pranohen edhe gra në administratën shtetërore në nivelet ku ato "nuk prishin punë" e nuk krijojnë probleme.

Përse vetëm 8 deputetë? Kjo për arsye të thjeshtë se kemi një mentalitet maskulist, si vendi i fundit i Ballkanit, ku Ballkani është i fundit i Evropës. Për fat të keq, duhet t'ia kemi zili edhe parlamentit të Kosovës, ku me ligj gratë përbëjnë

1/4 e auditorit. Mbase edhe media duhet të jete me e kujdeseshme e me e vemendeshme ndaj grave, duke zgjeruar spektrin e saj, jo duke ngelur në dy-tre figura qe, te sterlakuara, kthehen në një mit kokeposhte. Shqipëria është e pasur me gra qe kanë kontribute në të gjitha fushat. Parlamenti dhe shoqëria do të fitonte nga inteligjenca, ndershermeria, sinqeriteti, kultura, pse jo edhe nga butesia qe natyra femerore e ka në gen.

Gruaja dhe realiteti Shqiptar

nga Xhuljeta Jaho

Problemi i integritit të gruas në jetën shoqërore, politike, ekonomike, arsimore dhe në vendimarrje është shumë shqetësues për realitetin shqiptar. Është grupi më i madh shoqëror, i cili përbën 51.7% të popullsisë që nuk po gjen aspiratat e veta në fushat që përmenda më sipër. Integrimi i gruas është një proces jo vetëm të jashtëm, por si një proces të brendshëm: çfarë bëjnë vetë grujat për t'u integruar. Përballë gruas janë disa sfida që ajo duhet t'i kapërcejë, në mënyrë që të ngjisë shkallët e karrierës, si shoqërore ashtu edhe politike dhe këtu unë po përmend tre më kryesoret:

Gruaja përballë vetes - Është hapi i parë i domosdoshëm, ndërgjegjësimi dhe vetëndërgjegjësimi që ajo është e aftë të drejtojë, të menaxhojë, të bëjë politika dhe implementojë këto politika me sukses. Vetëbesimi, zotërimi nga ana e gruas plotësisht i aftësive të veta natyrore, intelektuale, profesionale etj. do të bëjë që ajo të përfaqësohet dinjitoze. Gruaja përballë shoqërisë - Nëse një grua duhet të përballet me vetveten, përballë shoqërisë ajo merr përmasa akoma edhe më të mëdha. Shoqëria është si një familje e madhe, ku përgjegjësia e gruas është akoma më e madhe. Pra, duke u nisur edhe nga fakti që gratë në jetën politike dhe institucionale janë në numër të vogël, ato pak gra duhet të jenë modeli më i mirë për t'u ndjekur si shembull nga gratë e tjera.



Përderisa qëllimi është i përbashkët ngritja e gruas në nivele ndryshme në jetën shoqërore, politike dhe vendimarrëse duhet të mbështetet nga mentalitete të ndryshme që vijnë nga mënyrat e ndryshme të jetesës, nga shtresat e ndryshme shoqërore dhe nga aftësitë e ndryshme natyrore.

Te reja pozitive

nga Liljana Mera

Në vitin 1993 Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave". Në janar 2003 Qeveria Shqiptare ka paraqitur në Komitetin e ë saj Konvente në OKB "Raportin kombëtar periodik fillestar dhe të parë". Raporti ishte një analizë e situatës politike e social-ekonomike të ushtrimit të të drejtave të grave në Shqipëri dhe të masave aktuale legjislative, kushtetuese dhe administrative të ndërmarrë nga shteti shqiptar. Ky raport është shpërndarë në të gjitha institucionet e pushtet legjislativ, qeveritar, gjyqësor, në pushtetin qëndror dhe vendor, në të gjitha organizatat joftimprurëse vendase dhe të huaja. Komiteti i Konventës i OKB në analizën e tij, vuri në dukje:

Tendenca pozitive: Përmirësimi i teksteve shkollore në një prespektivë gjinore; Ndërgjegjësimi i partive politike për nevojën për të rritur pjesëmarrjen e grave në marrjen e vendimeve; Përfshirja e sistemit të kuotimit në ligjin elektorale etj. Tendenca negative u vunë re: Mungesa e qartësisë që ka të bëjë me aplikimin të drejtpërdrejtë të Konventës; Mos rishikimi i ligjeve për të siguruar konformitetin me Konventën dhe disa klauzola që diskriminojnë gratë mund të vazhdojnë ekzistojnë; dhe mbipas kësaj analize Inkurajon

- Fuqizimin e Mekanizmit kombëtar për përparimin e grave
- Inkuaqimin e medias për të nxitur ndryshime kulturore
- Përdorimin e kuotave minimale të kandidatëve femra
- Përmirësimin në ligjin elektorale, duke zbatuar masa të përkohshme specifike

Komiteti kërkoi që komentet e tij të përhapen gjerësisht në Shqipëri, me qëllim që të bëhet më i ndërgjegjshëm populli shqiptar e në veçanti zyrtarët qeveritarë dhe politikanët mbi hapat që janë ndërmarrë për të siguruar de jure dhe de facto barazinë e grave dhe hapat e mëtejshëm në këtë aspekt.



Programi i zhvillimit të partive politike

nga Dan Redford



ishte të zhvillonte më tej aftësitë dhe njohuritë ekzistuese të udhëheqësve të ardhshëm në Shqipëri duke u siguruar anëtarëve të rinj të partive trainim dhe këshilla teknike.

Në vitet 1999 dhe 2000, NDI përzgjidhi 54 pjesëmarrësit e Programit nga 11 parti politike të cilët u trainuan mbi tema si Udhëheqësit Efektivë Punojnë me Anëtarët e Tyre; Roli i Partive Politike në Shoqërinë Demokratike, dhe Shtrirja e Partive Politike. Pjesëmarrësve iu kërkua të zhvillonin projekte që synonin forcimin e strukturave të partive të tyre. Kjo përqasje e orientuar nga veprimi siguroi mundësi të shkëlqyera për zbatimin praktik të aftësive të sapomësuar. Faza e tretë u zhvillua në 2001 dhe u përqendrua te aktivistët e rinj në degët e partive. Nëntëdhjetë pjesëmarrës u përzgjedhën nga partitë e tyre përkatëse dhe u trainuan në katër grupe shumëpartiake ngritur mbi baza rajonale.



Pjesëmarrësit priten të ndajnë atë që mësuuan në program me kolegët e tyre në parti. NDI u ka siguruar atyre udhëzime mbi teknikat e trainimit gjatë seminareve dhe ka organizuar seminare të Trainimit për Trainerë. Instituti vazhdon të punojë me të diplomuarit e të tri fazave të programit ndërkohë që ata zbatojnë projektet e tyre. Gjithashtu u ofruan dhe seminare të avancuar për pjesëmarrësit e interesuar në thellimin e njohurive të tyre në tema të tilla si menaxhimi i zgjedhjeve, etika dhe kualicionet politikë, ndërtimi i skuadrës, dhe zhvillimi i degës.



Në Shkurt 2003 NDI filloi një program që synon të bëjë më funksionale aftësitë e fituara në fazat e mëparshme duke prezantuar një skemë trainimi të menaxhimit politik. Pesëdhjetë pjesëmarrës u përzgjedhën nga një proces tepër konkurrues, të cilët po u ofrohet një program i plotë trainimi mbi menaxhimin, organizimin e partive politike dhe fushatën zgjedhore. Synimi është që të zhvillohen më tej aftësitë e fituara në fazat e mëparshme duke ofruar tani një udhëzues të plotë të menaxhimit politik dhe në të njëjtën kohë duke

zhvilluar lidhjet me programin tjetër të NDI në Shqipëri, Forumin Civil.

Kush janë njerëzit e NDI

Bordi i Drejtorëve të Institutit Kombëtar Demokratik

Madeleine K. Albright

Kryetare

Kenneth D. Wollack

President

Robert Benjamin

Drejtor Rajonal

Catherine Messina Pajic

Zëvendës Drejtoreshë Rajonale

William Hayden

Përgjegjës i Lartë i Programit

Megan Unangst

Asistente e Programit

Stafi i Programit të Zhvillimit të Partive Politike, NDI - Shqipëri

Jennifer L. Butz

Drejtoreshë e Zyrës Vendore dhe e

Programit Forumi Civil

Dan Redford

Drejtor i Programit të Partive Politike

Guri Daco

Asistent i Programit të Partive Politike

Enri Prodani

Konsulent i Programit të Partive Politike

Opinione për NDI



Arta Sakja:

Si do jetë e nesërmja e politikës?! Një përgjigje pozitive për këtë vjen nga NDI.



Reiz Mulita:

Padyshim, eksperiencia me NDI ka reflektuar sukses në ecurinë politike.



Taulant Balla:

Programi i NDI mbi Menaxhimin politik siguron përgatitjen efikase të gjeneratës së re të politikanëve shqiptarë.

Botues
Dan Redford
Redaktorë
 Alma Laha, Edvin Zoto, Guri Daco, Enri Prodani



Bordi Redaksional
 Arben Qirako, Roland Bejko, Antoneta Malja,
 Reis Mullita, Artan Cela, Etleva Bisha,
 Alban Zusi, Taulant Balla

Ky publikim u bë i mundur nga mbështetja e USAID



NDI
NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE
 FOR INTERNATIONAL AFFAIRS
ALBANIA

POLITIKANI I RI

REVISTA E PËRTREMUAJSHME E PROGRAMIT MBI
 MENAXHIMIN POLITIK TË NDI

www.ndi.org

E-mail: zhup@ndialbania.org

Nr.1 Qershor 2003